



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM

Nr. 86, datë 11.03.2021

PËR

**MIRATIMIN E “RAPORTI VJETOR MBI VEPRIMTARINË E KOMISIONIT
DISIPLINOR GJATË VITIT 2020”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 16, të nenit 62 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit Disiplinor;

V E N D O S I

1. Miratimin e “Raporti vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit Disiplinor gjatë vitit 2020”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
KOMISIONI DISIPLINOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më datë ____ . ____ . 2021



PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	3
2. KOMPETENCAT E KOMISIONIT DISIPLINOR.....	4
3. MIRATIMI I RREGULLORES “PËR PROCEDURAT DISIPLINORE NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR”.....	5
4. PROCEDURAT DISIPLINORE.....	6
5. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL ME INSPEKTORIN E LARTË TË DREJTËSISË.....	7
6. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	8

I. HYRJE

Komisioni Disiplinor është një ndër 4 komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Përbërja e tij u konstitua në mbledhjen plenare të Këshillit të datës 18.01.2019.

Në pikën 16, të nenit 62 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, parashikohet që: “Brenda muajit janar të çdo viti kalendarik, secili komision i përhershëm paraqet në mbledhjen plenare të Këshillit raportin vjetor të veprimtarisë me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.” Nisur nga ky

përcaktim ligjor nga ana e këtij Komisioni, u hartua raporti vjetor mbi veprimtarinë vjetore të tij përgjatë vitit 2020, si një nga aktet kryesore, i cili reflekton dhe raporton në mënyrë transparente përmbushjen me efikasitet dhe cilësi të përgjegjësive dhe detyrimeve të tij ligjore.

Në parantezë vlen të rikujtohet se veprimtaria gjatë vitit 2019 e Komisionit Disiplinor nuk ka qenë në pritshmërinë që legjislacioni, në kuadër të reformës në drejtësi, i ka kushtuar procesit disiplinor të gjyqtarëve, në kuadër të rritjes së besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Kjo ka ardhur si rezultat i vonesave në plotësimin e të gjithë arkitekturës së organeve të reja të drejtësisë si dhe vonesave në plotësimin e kuadrit ligjor në fuqi për sa i përket dispozitave që rregullojnë procedimin disiplinor.

Ndërsa, Këshilli i Lartë Gjyqësor është konstituar më datë 12.12.2018, Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë vitit 2019 nuk ishte zgjedhur ende. Procesi i zgjedhjes së tij, ka përfunduar me Vendimin nr.2, datë 20.01.2020 të Kuvendit të RSH. Nga ana tjetër, veprimtaria e këtij Komisioni, gjatë vitit 2019, u kushtëzua dhe nga vonesa në plotësimin e kuadrit ligjor, në kushtet kur Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr.34, datë 10.04.2017, shfuqizoi disa dispozita të Ligjit nr.96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, që kishin lidhje të drejtpërdrejtë me procedimet disiplinore të gjyqtarëve, konkretisht nenet 101 – 104, të cilat sanksiononin llojet e shkeljeve disiplinore.

Me plotësimin e vakumit ligjor të këtyre dispozitave, nëpërmjet Ligjit nr.48/2019, të miratuar më datë 18.07.2019, dhe zgjedhjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin nr.2, datë 20.01.2020 të Kuvendit të RSH, për Komisioni Disiplinor u krijuan kushtet bazë për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së tij, në përputhje me kompetencat e parashikuara në mënyrë të posaçme në ligjin nr.96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Gjatë vitit 2020, nga ana e Këshillit, u hasën problematika të tjera shtesë, siç ishte dhe pandemia globale e shkaktuar nga Covid -19 dhe pasojat e ardhura nga ndërprerja e ushtrimit të funksioneve ligjore të institucioneve të tjera, të cilat vendosën në provë jo vetëm veprimtarinë e këtij Komisioni, por dhe të gjithë sistemit gjyqësor në tërësi. Pavarësisht këtyre pengesave, veprimtaria e Komisionit Disiplinor gjatë vitit 2020, është karakterizuar nga përmbushja në kohë dhe me cilësi të gjitha detyrimeve dhe përgjegjësive ligjore, në kompetencë të tij.

II. KOMPETENCAT E KOMISIONIT DISIPLINOR

Në ushtrimin e kompetencave të tij kontributi i Komisioni Disiplinor, është i fokusuar në rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së gjyqtarëve gjatë ushtrimit të funksionit të tyre në përmbushje të misionit që Këshilli ka, në kuadër të qeverisjes, mbarëvajtjes dhe mirë-administrimit të sistemit gjyqësor.

Kompetencat e këtij komisioni parashikohen në Ligjin nr.115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, dhe Ligjin nr.96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe*

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Funkzioni i Komisionit Disiplinor, ndërvaret nga verifikimi i shkeljeve disiplinore dhe fillimi i procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve. Një përgjegjësi të tillë Kushtetuta¹ dhe Ligji nr.115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, ia ka ngarkuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë².

Me tej, është ligji nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar³, i cili rregullon funksionet dhe përgjegjësitë e secilit organ kushtetues, duke përcaktuar se veprimtaria e verifikimit disiplinor të ankesave dhe fillimi i procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve është nën kompetencën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndërsa veprimtaria e shqyrtimit të procedimit disiplinor dhe marrja e masave konkrete disiplinore është nën kompetencën e Këshillit.

III. MIRATIMI I RREGULLORES “PËR PROCEDURAT DISIPLINORE NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR”

Për shkak të natyrës së veçantë të procedurave individuale administrative disiplinore, të cilat ndryshojnë thelbësisht nga procedurat e tjera individuale në kompetencë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, hartimi i rregullave më të detajuara për zhvillimin dhe shqyrtimin e tyre u konsiderua prioritet nga ana e Komisionit Disiplinor.

Në këtë kuadër, në zbatim të neni 70, pika 2 e ligjit nr.115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar⁴, Komisionit Disiplinor ka hartuar dhe kaluar për miratim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Rregulloren “*Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor*”.

Me këtë rregullore është synuar standardizimi dhe vendosja e rregullave më të detajuara për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Komisionit Disiplinor dhe të mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në shqyrtimin e çështjeve që lidhen me procedura disiplinore të zhvilluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj gjyqtarëve të të gjithë niveleve. Objekt rregullimi është e gjithë veprimtaria administrative dhe procedurale, duke filluar nga momenti i paraqitjes dhe më pas

¹ Neni 147/d pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë – “*1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj... .*”

² Neni 194 i ligjit nr.115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar – “*Objekti i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë... .*”

³ Amendimi i fundit i këtij ligji i përket Gushtit të vitit 2020, miratuar me ligjin nr.15/2020, datë 12.02.2020.

⁴⁴ Neni 70, pika 2 e ligjit nr.115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar⁴ - “*Zbatimi me analogji i rregullave për komisionet e Këshilli*” -... 2. *Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla të detajuara për organizimin dhe funksionimin e komisioneve.*”

shqyrtimit dhe administrimit të dokumentacionit që lidhet me procedurat disiplinore, duke përfshirë krijimin, trajtimin, qarkullimin, shfrytëzimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit që bëhet pjesë e dosjes së procedurës disiplinore, si dhe sigurimin e aksesit të subjekteve pjesëmarrëse në këtë dokumentacion.

Rregullorja “*Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor*”, përcakton qartë rregullat e sjelljes për të gjitha subjektet procedurale. Në një seksion të veçantë janë vendosur parashikime për mënyrën e shqyrtimit nga Këshilli të procedimeve disiplinore të paraqitura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, duke synuar zhvillimin e kësaj procedure të veçantë, në përputhje me parimet e vendosura shprehimisht në ligj dhe në veçanti me parimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke përfshirë dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm.

Projekt rregullorja është shqyrtuar dhe miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.316, datë 14.09.2020 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr.166, datë 16 Shtator 2020.

IV. PROCEDURAT DISIPLINORE

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit Disiplinor janë përfunduar në Këshill tre procedura disiplinore nga të cilat 1 procedurë më objekt pezullimin e një magjistrati nga detyra dhe dy procedime disiplinore, të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Kërkesa e parë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor është depozituar pranë Këshillit, në datë 24.09.2020.

- ✓ **Me vendimin nr.315, datë 14.09.2020** të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në zbatim të parashikimeve të neneve 151, pika 1, shkronja “a” dhe 155 të Ligjit nr.96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, është vendosur pezullimi nga detyra e magjistrates M.M. Procedura administrative është iniciuar kryesisht nga Komisioni Disiplinor, bazuar në informacionin e njoftuar nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
- ✓ **Me vendimin nr.529, datë 27.10.2020** të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të magjistratit Sh.M, bazuar në nenin 140, pika 2, germa b) të Kushtetutës dhe në nenin 111 të Ligjit nr.96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, i cili ishte i është dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e veprës penale të “*Korrupsionit pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.

- ✓ **Me vendimin nr.633, datë 10.12.2020** të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur pranimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të magjistratit M.K, parashikuar në nenin 140, pika 2, germa a) të Kushtetutës dhe nenin 111 të Ligjit nr.96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, në kushtet kur u provua se magjistrati në vendimmarrjen e tij ka kryer shkelje shumë të rënda profesionale, duke diskretituar rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës.

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në datë 10.12.2020, është depozituar kërkesa e tretë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates E.H. Me vendimin nr.636, datë 16.12.2020 të Këshillit, është vendosur hedhja e shortit dhe caktimi i anëtarit të Komisionit Disiplinor dhe me vendimin nr.646, datë 23.12.2020, është vendosur data 08.01.2021, ora 11:00, si datë e zhvillimit të seancës së parë dëgjimore.

V. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL ME INSPEKTORIN E LARTË TË DREJTËSISË

Komisioni Disiplinor ka trajtuar në kohë të gjitha ankesat e ardhura në drejtim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për shkelje të pretenduara nga ana e gjyqtarëve të caktuar, duke orientuar këto subjekte ankuese drejt ndjekjes së rrugës së duhur ligjore për zgjidhjen e tyre në kohë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si organi i vetëm kushtetues përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve.

VI. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Gjatë shqyrtimit të procedimeve disiplinore në Këshill, Komisioni Disiplinor ka hasur disa problematika, të cilat kanë diktuar ndërhyrje në ligjin nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar. Konkretisht:

- ❖ Referuar neneve 133 dhe 138 të ligjit parashikohet se, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me përfundimin e hetimit, harton raportin e hetimit dhe fillon procedimin disiplinor ndaj magjistratit, duke paraqitur këtë raport së bashku me dosjen hetimore në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Ndërsa, bazuar në nenin 135 të ligjit, parashikohet se Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati në çdo kohë mund të dakordësojnë marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur më shkeljen disiplinore që i atribuohet magjistratit.

Në lidhje me këto dispozita neni 129, pika 3 e ligjit parashikon në mënyrë urdhëruese detyrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për njoftimin magjistratit, të vendimit të arkivimit të ankesës, vendimit për fillimin e hetimit, shtimin apo ndryshimin e objektit të tij, si dhe vendimit për mbylljen e hetimit, por nuk parashikon njoftimin e raportit të hetimit për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin për caktimin e masës disiplinore.

Mungesa e parashikimit të njoftimit magjistratit të raportit të hetimit ka sjellë si pasojë:

- shtyrjen e seancës së parë dëgjimore nga ana e Këshillit në zbatimin e parimit për një proces të rregullt ligjor dhe barazisë para ligjit;
 - ngritjen nga magjistratit të çështjes për zgjidhjen me marrëveshjen e përbashkët të pranimin, në kushtet kur për raportin e hetimit, i cili përmban dhe analizën përfundimtare të ligjit dhe faktit, ai njihet gjatë procedurës në Këshill.
- ❖ Nga data e fillimit të procedimit disiplinor nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli duhet të caktojë brenda një muaji seancën dëgjimore, të njoftojë palët të paktën 15 ditë para saj si dhe të shqyrtojë të gjithë faktorët që kanë rëndësi për çështjen. (nenet 138 dhe 141 të ligjit).

Para se nga ana e Këshillit të vendoset për caktimin e seancës dëgjimore dhe njoftimin e palëve, një vendimmarrje e rëndësishme e tij është dhe mbyllja e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, sipas nenit 139 të ligjit.

Rekomandim 2

Në nenin 135 të ligjit, duhet të përcaktohet qartë deri në cilin moment të procedurës të zhvilluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë apo nga Këshilli, palët kanë mundësi të dakordësojnë marrëveshjen e përbashkët të pranimin. Në këtë aspekt rekomandohet që magjistrati duhet të ketë një kohë të arsyeshme për dakordësimin e marrëveshjes nga momenti i njoftimit të raportit të hetimit, nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Rekomandim 3

Në lidhje me këto parashikime, duke mbajtur në konsideratë faktin se Këshilli dhe Komisioni Disiplinor organizohen dhe funksionojnë si organe kolegjinale, si dhe faktin se procedura të tilla mbartin një fazë përgatitore komplekse, për shkak të natyrës së tyre quasi gjyqësore, rekomandohet që nga neni 138 pika 2, shkronja “a” e ligjit të parashikohet një afat më i gjatë se një muaj për caktimin e seancës dëgjimore.

nenin disiplinor.

- ❖ Kushtetuta në nenin 147/d të saj ka parashikuar: *“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj... .”*Në zbatim të parashikimeve kushtetuese, ligji Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton dhe rastet e mbarimit të statusit të magjistratit. Sipas nenit 64 parashikohet se: *“1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen; b) vërtetohen kushtet e pa zgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; c) mbush moshën 67 vjeç; ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; d)vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën... .”*

Në këtë kontekst, sipas parashikimeve të neneve 134 dhe 139 të ligjit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, ndërsa Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos mbylljen e procedimit disiplinor, pa zhvilluar seancë dëgjimore, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d” të ligjit. Në rastin e paraqitjes së dorëheqjes së magjistratit, kjo dorëheqje nuk ndalon fillimin ose vazhdimin e procedimit disiplinor.

Rekomandim 4

Në nenin 65 të ligjit duhet të parashikohet shprehimisht vendimmarrja e Këshillit në rastet kur nga magjistrati, ndaj të cilit ka filluar një procedurë hetimore, është paraqitur kërkesa për mbarimin e statusit me dorëheqje.

Nga interpretimi sistematik i këtyre dispozitave, del qartë se paraqitja e dorëheqjes së magjistratit nuk përbën shkak për mbylljen e hetimit dhe fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të tij. Paqartësia në interpretimi shfaqet në raport me nenin 65 të ligjit, në kushtet kur në këtë nen parashikohet detyrimi i Këshillit për të deklaruar me vendim mbarimin e statusit të magjistratit jo më vonë se dy javë nga paraqitja me shkrim e dorëheqjes, e cila konsiderohet si mbarim i statusit.

Problematika e dytë shfaqet në rastin kur shkelja konstatohet brenda afatit të parashkrimit të parashikuar nga neni 117 i ligjit, por ndërkohë magjistrati i ka mbaruar statusi me dorëheqje dhe nga ana e Këshillit është deklaruar me vendim një fakt i tillë.

Rekomandim 5

Në nenet 120 dhe 124 duhet të parashikohet qartë vendimmarrja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për ankesat apo rastet e konstatimit të shkeljeve, të kryera nga magjistrati në kohën kur ai ka qenë në detyrë, por konstatimi i të cilave ka ndodhur në kohën kur atij me vendim të Këshillit të Lartë Gjqësor, i është deklaruar mbarimi i statusit me dorëheqje.

2. Në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore, neni 140 i ligjit ka parashikuar bashkimin e procedimeve. Aktualisht, në Këshillin e Lartë Gjqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar procedimin disiplinor për të njëjtat shkelje ndaj një gjyqtari dhe prokurori. Mungesa e rregullave të përbashkëta bën të pamundur bashkimin e këtyre procedimeve në një të vetëm, në rast të përballjes së Këshillit më një kërkesë të tillë në të ardhmen.

Rekomandim 6

Në përmbushje të detyrimeve të parashikuar nga neni 140 i ligjit duhet që Këshillat të bashkëpunojnë midis tyre në hartimin dhe miratimin sa më shpejt të rregullave të përbashkëta për bashkimin e procedimeve në funksion të qëndrimeve të unifikuara në zbatimin e faktit dhe ligjit ndaj të njëjtave shkelje.